



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Regulativni Autoritet Železnica

Railway Regulatory Authority



Në bazë te nenit 38, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:



Rregullore për Regjistrimin e Infrastrukturës Nr. 06/2012

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i Rregullorës është që te krijojë Regjistrin e Infrastrukturës, i quajtur këtej e tutje RINF, me qëllim të harmonizimit të RINF në Republikën e Kosovës në një mënyrë të qartë dhe transparente.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kesaj Rregullore zbatohen per te gjithe operatorët momental dhe ata të ardhshëm të cilët duhet te kene tabelat e harmonizuara te regjistrimit, informatat e kerkuara per RINF, dhe rregullat se si te mbahet dhe perditesohet RINF.

Neni 3 Organet përgjegjëse

1. Secili Menaxher i Infrastrukturës i krijuar në Kosovë është përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e RINF.
2. Secili Menaxher i Infrastrukturës i krijuar në Kosovë është përgjegjës për raportimin e çdo ndryshimi te ARH si organ përgjegjës për sigurinë.
3. ARH si organ përgjegjës për sigurinë është përgjegjës për mbikqyrjen e RINF dhe për te siguruar se RINF është mbajtur dhe përditësuar siç duhet.
4. ARH si organ përgjegjës për sigurinë është përgjegjës për publikimin e RINF

Për me shumë informata ju lutem shiqoni në faqen e internetit të ARH- www.arh-ks.org.

Neni 4 **Detyrimet e Menaxherit të Infrastrukturës**

1. Nga Menaxheri i Infrastrukturës kërkohet të kryhen detyrat e mëposhtme:

1.1 Të regjistroni të gjithë infrastrukturën tuaj ekzistuese, që ende nuk është regjistruar në tabelë

1.2 Regjistrimin e të gjithë infrastruktures së re

1.3 Regjistrimin e të gjithë infrastruktureve së regjistruar e cila ka pësuar ndryshime

1.4 Të hiqet nga RINF infrastruktura që ju dëshironi të tërhiqet

2. Operimi në infrastrukturë pa një regjistrim të përshtatshëm në RINF do të konsiderohet si një kundërvajtje në bazë të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

Neni 5 **Tabela RINF dhe informatat e kërkuaara**

1. Ju do të gjeni tabelën në faqen e internetit të ARH- www.arh-ks.org.

2. Ne kërkojmë të dhënat e mëposhtme në lidhje me infrastrukturën tuaj dhe infrastrukturën e nënsistemeve të cilat janë të përfshira në listën e nënsistemeve në shtesën II të Direktivës 2008/57/EC.

3. Ne kemi numëruar nënsistemet më të rëndësishme për infrastrukturën e Kosovës. Menaxheri i infrastrukturës është e lirë për të shtuar ndonjë nënsistem më shumë gjatë procesit të modifikimit tij të ose modernizimit të infrastrukturës pas marrjes së miratimit tonë.

Neni 6 **Regjistrimi i Infrastrukturës së re**

1. Në mënyrë që të regjistroni infrastrukturë të re ju keni nevojë për një deklaratë të verifikimit.

2. Nëse deklarata e verifikimit është e lëshuar nga një organ i akredituar në Bashkimin Evropian, ju mund ta regjistroni nëse keni pranuar aprovimin nga ARH si organ përgjegjës për siguri.

3. Sipas Ligjit të hekurudhave, shpallja e verifikimit të lëshuar nga një organ i akredituar në Bashkimin Evropian konsiderohet të jetë e vlefshme në qoftë se është në përputhje me legislacionin e Kosovës.

4. Nëse deklarata e verifikimit është lëshuar nga një organ kombëtar i akredituar, ju mundeni të regjistroni automatikisht infrastrukturën e re.

5. Nëse deklarata e verifikimit është lëshuar nga një organ i akredituar i pjesëmarrësve SEETO-s, ajo kërkon aprovinin të qartë të ARH si organi përgjegjës për sigurinë deri sa Marrëveshja e Komunitetit të Transportit të hyjë në fuqi.

6. Nëse deklarata e verifikimit është lëshuar nga një organ i akredituar i një vendi të tretë, ajo kërkon miratimin të qartë të ARH si organi përgjegjës për sigurinë.

Neni 7 **Regjistrimi i Infrastrukturës së ndryshuar**

1. Me qëllim që të regjistroni infrastrukturën, që është ndryshuar (modifikuar), ju keni nevojë për një deklaratë të verifikimit.
2. Ndryshimi përfshin rinoimin dhe përmirësimin e çdo nënsistemi të renditur në tabelë. Ju do të gjeni tabelën në faqen e internetit të ARH-www.arh-ks.org.
3. Në rastin e rinoimit ose të përmirësimit të një nënsistemi, subjekti kontraktues, për shembull, kompania e ndërtimit ose prodhuesi, do të dërgojë të ARH si organ përgjegjës për sigurinë, një dosje që përshkruan projektin.
4. Pas shqyrtimit ARH do të vendosë nëse shtrirja e punëve do të thotë një autorizim të ri përvendosjen në shërbim, ose një ndryshimin të infrastrukturës. Në rastin e mëparshëm Neni 6 do të aplikohet.
5. Për deklaratën e verifikimit të një infrastrukturës së ndryshuar neni 6 do të zbatohet në mënyrë analoge.

Neni 8 **Procedurat**

1. Ju jeni të obliguar të na dërgoni versionin e fundit të RINF sa herë që ju keni infrastrukturë të re dhe ndryshime të rëndësishme.
2. Ju jeni të obliguar të na dërgoni versionin e fundit të RINF një herë në vit, kur ju keni vetem ndryshime të vogla.

Neni 9
Diskutimet jo zyrtare

1. Ne mirëpresim kontaktet jozyrtare në çdo fazë dhe para se të filloni krijimin e RINF.
2. Ne do të shpjegojmë kushtet e regjistrimit, të ndihmojmë në identifikimin e informacionit dhe për të diskutuar këtë me ju.
3. Por, udhëzimet në një fazë të hershme mund të jenë të vlefshme, ju kursejnë kohë dhe shpenzime.
4. Diskutimet jozyrtare mund të jenë të rëndësishme kur ju dëshironi të instaloni infrastrukturë të re ose për të ndryshuar infrastrukturën tuaj.

Neni 10
Kriteret e Vlerësimit

1. Kriteret tona kryesore të vlerësimit janë parashikimet e përcaktuara në Vendimin 2008/57/EC dhe në anekset në Specifikimin Teknik të ndërveprimit TSI, dhe
2. Siq është përcaktuar në bazë të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

Neni 11
Njoftimi, publikimi dhe informimi

1. Ju duhet të na njoftoni kur të keni përfunduar regjistrimin për herë të parë dhe sa herë që ju do të ndryshoni RINF.
2. Ne do të publikojmë RINF në faqen tonë të internetit.
3. Ju jeni të lirë gjithashtu për të publikuar RINF.
4. Ne do të informojmë Agjencinë Evropiane hekurudhere (ERA) në lidhje me RINF.

Neni 12
Konfidencialiteti

1. Ne jemi të përkushtuar të hapur dhe transparent, por ne vlerësojmë se gjatë një aplikimi ju mund të merrni informacion që është më ndjeshmeri komerciale.
2. Ju duhet të na pyesin për të trajtuar informatat e ndjeshme si " komerciale ". Ju lutemi të tregoni qartë kur rasti është i këtillë.

**Neni 13
Zbatimi**

1. Ne jemi kompetent për zbatimin e regjistrimit të infrastrukturës dhe infrastrukturës së nënsistemeve.
2. Sipas Ligjit Hekurudhor ju jeni subjekt i gjobave, nëse ju nuk bëni përditësimin e saktë të RINF.

**Neni 14
Jo Diskriminimi**

Nëse ju besoni që do të diskriminoheni apo jeni të trajtuar padrejtësisht ose në ndonjë mënyrë tjetër dëmtuar me vendimin tonë, ju keni të drejtë të paraqesni ankesë në ARH, i cili vepron si organ i ankeses për tregun hekurudhor.

**Neni 15
Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Halit Gara,
Kryetar i Bordit
Prishtinë, 19/10/2012

